

Data 17.08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Kancelari”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Stilolapsa
30192124-6 , Lapsa 30192130-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 745 392 (një milion e shtatëqind e dyzet e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa t.v.sh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gjirokastr** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

.....
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2023, 2024, 2025**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo me te vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "b", të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "b", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit** të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20. % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë, me shpenzimet e veta, transportin, shkarkimin e mallrave në ambientet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, sipas specifikimeve teknike dhe brenda afateve të kontratës.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme është e nevojshme për të garantuar dorëzimin e mallrave në ambientet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe realizimin e plotë të furnizimit, pa krijuar kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

2.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësive, ose ekuivalente, të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës.

- a) Certificate ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësive/ **ekuivalente dhe e vlefshme**

- Në rastet e paraqitje se ofertes nga nje Bashkim të Operatorësh ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, ne perputhje me natyren dhe zerat e mallrave qe merr persiper te sipas marveshjes se bashkepunimit).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e Certifikatës ISO 9001:2015 ose ekuivalente bazohet në nevojën për të garantuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës zbatojnë një sistem të standardizuar të menaxhimit të cilësisë dhe kanë kapacitetet e nevojshme organizative për realizimin e furnizimit sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kjo kërkesë synon të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e mallrave objekt prokurimi, si dhe respektimin e kërkesave teknike gjatë furnizimit. Pranimi i certifikatave ekuivalente siguron trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe nuk kufizon konkurrencën.

2.6 Operatorët Ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Nr	Emertimet e artikujve
19	Dosje me llastik 24-26*34-35
20	Dosje me mekanizem 7 cm A4
21	Dosje me mekanizem 7 cm A4 me kapak
75	Makine kapse faqe 24/6
76	Makine llogaritese 12 digt ekran I levizshem dimesion 15x19 dual power
77	Meter lazer 60m, me saktesi 1.5 mm ekran LCD, funksione siperfaqe/vellim/pitagora
115	Stilolapsa blu 0.7mm
117	Stilolapsa te kuq 0.7mm
138	Vizore skalimeter 30 cm me shkalle 1:20,50, 100, 200, 300, 500

- Mostrat do të paraqiten **në ditën dhe orën e hapjes së ofertave** të percaktuar në dokumentat e tenderit pranë zyrës së Protokoll- Arkiv pranë Bashkisë Gjirokastër.
- Per paraqitjen e mostrave do të mbahet proces –verbal për të administruar procesin e dorezimit midis Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Operator-it/ eve Ekonomik.
- Ky kriter i shërben AK për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara me qëllim që cilësia të jetë në përputhje me kërkeat për rokurim.

- Mostrat do të jenë me etiketë të ngjitur e cila tregon ” emërtimin e artikullit ” numrin rendor sipas preentivit të ngarkuar dhe ofertës së tyre, emrin e ofertuesit dhe vulën e operatorit ekonomik.
- Mostrat e paraqitura do të trajtohen si informacion konfidencial tregëtar dhe do të jenë në kontroll të AK
- **Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.**
- Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike përbën kusht për skualifikim.
- Operatori ekonomik fitues do të dorëzojë mallin pas lidhjes së kontratës të njëjta me mostrat e dorëzuara në të kundërt përbën kusht për zgjidhje kontrate.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e mostrave për artikujt e përcaktuar në pikën më lart ka për qëllim sigurimin e verifikimit të drejtpërdrejtë dhe objektiv të përputhshmërisë së produkteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Paraqitja e mostrave është e domosdoshme për vlerësimin e saktë të karakteristikave fizike, dimensioneve, materialit, funksionalitetit dhe elementeve të tjera teknike të artikujve, të cilat nuk mund të verifikohen në mënyrë të plotë dhe të besueshme vetëm nëpërmjet dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Mostrat përbëjnë një mjet të drejtpërdrejtë verifikimi për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, duke mundësuar krahasimin efektiv të produkteve të ofruara me kërkesat e specifikimeve teknike dhe duke garantuar një proces vlerësimi objektiv, transparent, të paanshëm dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Kjo kërkesë është e kufizuar vetëm në ato artikuj për të cilët verifikimi fizik konsiderohet i domosdoshëm për të garantuar përputhshmërinë teknike dhe funksionale, dhe nuk synon në asnjë rast kufizimin e konkurrencës, favorizimin e ndonjë operatori ekonomik, apo përcaktimin e markës, origjinës apo prodhuesit, por vetëm sigurimin e përmbushjes së plotë të kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Në përfundim, paraqitja e mostrave përbën një masë të arsyeshme, proporcionale dhe të justifikuar, e cila i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë në mënyrë të besueshme përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike dhe funksionale, duke minimizuar rrezikun e furnizimit me produkte që nuk përmbushin standardet dhe nevojat e institucionit.

Nr	Emertimet e artikujve	Argumentimi
19	Dosje me llastik 24-26*34-35	Paraqitja e mostrës kërkohet për verifikimin fizik të përmasave, materialit, trashësisë dhe mënyrës së mbylljes me lastik, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike të kërkuara.

20	Dosje me mekanizem 7 cm A4	Mostra kërkohet për të verifikuar përmasat, materialin, kapacitetin dhe funksionalitetin e mekanizmit të dosjes, të cilat janë elemente të rëndësishme për përdorimin e saj në administrimin dhe arkivimin e dokumenteve.
21	Dosje me mekanizem 7 cm A4 me kapak	Paraqitja e mostrës mundëson verifikimin e përmasave, materialit, cilësisë së kapakut dhe funksionalitetit të mekanizmit, duke garantuar përputhjen me kërkesat e përcaktuara.
75	Makine kapse faqe 24/6	Mostra kërkohet për të verifikuar tipin, përmasat, mekanizmin e kapjes dhe funksionalitetin e pajisjes, si dhe përshtatshmërinë e saj për përdorim me kapëset 24/6.
76	Makine llogaritese 12 digt ekran I levizshem dimesion 15x19 dual power	Paraqitja e mostrës është e nevojshme për verifikimin fizik të pajisjes, numrit të shifrave të ekranit, funksioneve të kërkuara, mënyrës së furnizimit me energji dhe funksionalitetit të saj.
77	Meter lazer 60m, me saktësi 1.5 mm ekran LCD, funksione sipërfaqe/vellim/pitagora	Mostra kërkohet për verifikimin e kapacitetit të matjes, ekranit, saktësisë së matjes dhe funksioneve të përcaktuara në specifikimet teknike, të cilat janë të rëndësishme për përdorimin praktik të pajisjes.
115	Stilolapsa blu 0.7mm	Paraqitja e mostrës mundëson verifikimin e ngjyrës së shkrimit, trashësisë së majës 0.7 mm, cilësisë së shkrimit dhe karakteristikave fizike të produktit.
117	Stilolapsa te kuq 0.7mm	Mostra kërkohet për të verifikuar ngjyrën e shkrimit, trashësinë e majës 0.7 mm, cilësinë dhe funksionalitetin e stilolapsit, në përputhje me kërkesat teknike.
138	Vizore skalimeter 30 cm me shkallë 1:20,50, 100, 200, 300, 500	Paraqitja e mostrës është e nevojshme për verifikimin e gjatësisë, materialit, cilësisë së përpunimit dhe pranisë së shkallëve të përcaktuara, duke siguruar përshtatshmërinë e produktit për përdorimin e kërkuar.

2.7 KUJDES KODET BUXHETORE SI ME POSHTË:

Nr	Kodet Buxhetore	Vlera
1	V111AAD	914,374
2	V111AAB	37,900
3	V043AAA	101,945
4	V822AAD	37,405
5	V823AAB	16,908
6	V476AAB	41,990
7	V328AAC	40,940
8	V626AAF	33,995

9	V912AAB	225,390
10	V923AAB	228,830
11	V912AAF	27,060
12	V424AAB	21,995
13	V426AAB	16,660

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ofertojë sipas vlerave të kodeve buxhetore perkatëse në preventiv në të kundërt përbën kusht për skualifikim pasi autoriteti kontraktor nuk mund të lidhë kontratë me vlera më të larta se ato të cilat ajo disponon.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe sipas Udhezimi nr 23 dt 30.07.2018 per procedurat standartente te programit buxhetor afatmesem te njesive te veteqeverisjes vendore. Per cdo program buxhetor buxheti eshte i ndare dhe i percaktuar me vkb sipas produkteve qe lidhen ne funksionet e atij programi.

Kërkesa e mësipërme është e nevojshme për të garantuar likuidim të plot për operatorin fitues nga Autoriteti Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSI E PROKURIMIT

Rigelsa Alikaj

Lorjana Shehu

Esmeralda Bezhani